



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
31.01.2023**

Me datë 31.01.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Bledianë Nika, Nersada Mandija, Aurora Dibra, Diana Muriqi, Tereze Brigja, Jona Leqeja, Vjollca Petani, Daniela Jakoja, Dhurata Tyli, Sabina Danaj, Donika Ndoja, Kristi Agnes Shllaku, Valbona Doniku, Suada Selimaj, Lumnije Guri, Gezim Galiqi, Erion Metushi, Oltion Luli, Luan Heta, Hilmi Lakti, Gerald Hasaj, Sokol Zaimaj, Anton Deda, Gjergj Sokoli, Andi Hallunaj, Luigj Palushi, Nadir Spahija, Lindita Nika.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim “Për miratimin e kritereve për dhënien e ndihmiës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar 6% për ndihmën ekonomike”
2. Pr/ Vendim “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2022”
3. Pr/ Vendim “Për miratimin e ndryshimit të emrit të rrugës “Bostanëve”, në rruga “Remzi Hoxha”
4. Pr/ Vendim “Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Vekshar, në Rrugë “Mustaf Daija”
5. Pr/ Vendim “Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Sami Repishti, në Rrugë Anamaleve”
6. Pr/ Vendim “Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Fetih Dizdari në rrugën Sami Repishti”
7. Pr/ Vendim “Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Hysen Lacej në rruga Hasan Muhamet Halluni”

8. Pr/ Vendim "Për miratimin e ndryshimit të emrit të rrugës Vatë Martini" në rruga Aleks Nika, më njësinë administrative Velipojë"
9. Pr/ Vendim "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024"
10. Pr/ Vendim "Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me VKB nr.71, datë 27.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër"
11. Pr/ Vendim "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2022"
12. Pr/ Vendim "Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit social për vitin 2023, për realizimin e një kati shtesë në objektin banesa sociale me qira (ish konviki i shkollës veterinare), i përshtatur për shërbim social"
13. Pr/ Vendim "Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2023"
14. Pr/ Vendim "Për një ndryshim në VKB nr.27, datë 1.6.2016 "Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër"
15. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur nga kryetarja e Këshillit e cila sqaron që mbledhja do ndiqet live edhe në rrjetin social (facebook).

Para se të vijohet me votim e rendit të ditës Zv.Kryetari i bashkisë Z.Dedaj kërkon të tërheq nga ky rend dite pikën 10, e cila ka të bëjë me një tentativë për bashkëfinancim në ndërtimin e një ure në fshatin Rragam, por meqënëse është urgjent ndërtimi i saj ne kemi kontaktuar në formë shkresore me Prefekturën si dhe me Agjensinë e Emergjencave Civile dhe me Ministrinë e Mbrojtjes që të arrijmë më shpejt një bashkëfinancim për urën në fjalë. Jemi në pritje të miratimit final për këtë. Prandaj nuk mund të kërkojmë në këshill miratimin e kësaj pike përderisa nuk kemi një praktikë të mirfilltë për këtë.

Hidhet në votim rendi i ditës me propozimin e Z.Dedaj, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

**Miratohet**

**1.Mbledhja vijon me Pr/ Vendim “*Për miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondon e kushtëzuar 6% për ndihmën ekonomike ”***

N/Kryetari i Bashkisë merr fjalën dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Në emër të komisionit për çështjet sociale, Znj.Mandija shprehet pro këtij Pr/vendimi.

Nga këshilltarën fjalën e merr Znj.Mandija e cila shpreh rezervat e saj për pikën 1 dhe 2 të këtij Pr/vendimi,ku mendon se ka paqartësi.

Z.Dedaj përgjigjet se ky kriter shërben për të përjashtuar nga kjo fashë disa familje të cilat nuk kanë pikë të rjaftueshme por shprehet dakort për ndryshimet e propozuara për lehtësimë në dokumentacionin përfituesit.

Znj.Mandija shprehet se nuk e sheh të arsyeshme të kërkohen dokumente shtesë për familjet përfituese duke qënë se ato vijnë të filtruara nga sistemi Kombëtar i Ndihmës Ekonomike.

Projekt akti i parë hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.

#### **Miratohet**

**2.Vijohet me pikën 2. të rendit të ditës: Pr/ Vendim “*Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondon e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Dhjetor 2022 ”***

Përsëri Z.Dedaj relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Në emër të komisionit për çështjet sociale, Znj.Mandija shprehet pro Pr/vendimit. Edhe kryetarët e grupeve Znj.Dibra dhe Z.Sokoli janë pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Përpara se të vijohet me pikën në vazhdim, kryetarja e këshillit Znj.Kadija propozon se meqënëse nga pika 3 deri tek pika 8 e rendit të ditës janë Pr/vendime për emërtesa rrugësh, ato do relatohen njëherazi por do votohen ndarazi.

Z.Dedaj vijon me relatimin e pikave të sipër përmendura    sipas relacioneve përkatëse të përgatitura nga administrata.

Z.Galiqi merr fjalën dhe ka një pyetje për zv/Kryetarin e bashkisë.Ai kërkon të dijë cilët janë anëtorët e komisionit që do krijohet për të gjykuar dhe vlerësuar emertësat e rrugëve.

Përgjigjet Z.Dedaj, i cili sqaron se drejtoria e planifikimit do ketë peshën më të madhe por gjithmonë emrat e propozuar janë personalitetë të vlerësuara me tituj nderi. Pra janë strukturat e Bashkisë Shkodër që janë përgjegjës për këtë, por akoma nuk kemi një komision të mirëfilltë për këtë.

Znj.Leqeja shprehet mbi rëndësinë e një komisioni vlerësues për emërtesat e rrugëve, shesheve, monumenteve para se pr/vendimet të paraqiten në Këshill për miratim.

Z.Dedaj thotë se propozimet vijnë me firmën e Kryetarit të bashkisë, por mbetet në gjykimin e këshilltarëve nëse do miratohet apo jo.

Znj.Kadija sqaron se kërkesa për krijimin i një komisioni të tillë vlerësues nuk ka ardhur në këshill por nëse vullneti i palëve ekziston atëherë kjo mund të jetë e mundur. Propozimet mund të vijnë jo vetëm nga Kryetari i bashkisë por edhe nga banorë të zonës, nga këshilltarë prandaj ka gjithmonë nevojë për filtrim në vlerësim.

Znj.Leqeja thotë përsëri që të krijohet deomos një komision që të shërbejë si strukturë filtruuese dhe të krijojë standarte.

**3.**Kalohet tek mendimi i kryetaëve të grupeve: Znj Dibra shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti nr.3, Pr/ Vendim “*Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Bostanëve*”,në rruga “*Remzi Hoxha*” hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**4.**Kërkohet mendimi i kryetaëve të grupeve për Pr/ Vendim “*Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Vekshar, në Rrugë “Mustaf Daija”*”. Znj Dibra shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti nr.4 hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**5.** Kalohet përsëri tek mendimi i kryetaëve të grupeve për Pr/ Vendim “*Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Sami Repishti, në Rrugë Anamaleve*”. Znj Dibra shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti nr.5 hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**6.** Vijohet me mendimin e kryetaëve të grupeve: Znj Dibra shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti nr.6, Pr/ Vendim “*Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Fetih Dizdari në rrugën Sami Repishti*” hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**7.** Kalohet tek mendimi i kryetaëve të grupeve për Pr/ Vendim “*Për miratimin e ndryshimit të emrit të një segmenti të rrugës Hysen Lacej në rruga Hasan Muhamet Halluni*”. Znj Dibra shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti nr.7 hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

8. Përsëri kalohet tek mendimi i kryetaëve të grupeve: Znj Dibra shprehet pro miratimit, po ashtu edhe Z.Sokoli. Projekt akti nr.8 Pr/ Vendim “*Për miratimin e ndryshimit të emrit të rrugës Vatë Martini*” në rruga Aleks Nika, më njësinë administrative Velipojë hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

**Miratohet**

9. Vijohet me pikën 9 të rendit të ditës: Pr/ Vendim “*Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024*”.

Fjala përsëri për Z.Dedaj,i relaton shkurtimisht sipas relacionit të përgatitur.

Në emër të komisionit Z.Leqejza shprehet pro miratimit të këtij pr/vendimi, po ashtu edhe kryetarët e grupeve të këshilltarëve shprehin dakortësi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

**Miratohet**

Vijohet me pikën 11. të rendit të ditës: Pr/ Vendim “*Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2022*”

Relaton përsëri Z.Dedaj në mënyrë të detajuar në bazë të materialit të përgatitur nga administrata.

Në emër të komisionit, Znj.Mandija shprehet pro Pr/vendimit. Edhe kryetarët e grupeve Znj.Dibra dhe Z.Sokoli janë pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

**Miratohet**

12. Vijohet me pikën 12 të rendit të ditës: Pr/ Vendim “*Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit social për vitin 2023, për realizimin e një kati shtesë në objektin banesa sociale me qira (ish konvikti i shkollës veterinarë), i përshtatur për shërbim social*”

Përsëri fjala për Zv/kryetarin, Z.Dedaj i cili shkurtimisht relation në përbledhje të relacionit të paraqitur nga administratë.

Në emër të komisionit, Znj.Mandija shprehet pro Pr/vendimit. Edhe kryetarët e grupeve Znj.Dibra dhe Z.Sokoli janë pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

**Miratohet**

13. Vijohet me pikën 13. të rendit të ditës: Pr/ Vendim “*Për miratimin e listës së përsituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2023*”

Relaton përsëri Z.Dedaj. Znj.Mandija në emër të komisionit shprehet pro miratimit të pr/vendimit. Edhe kryetarët e grupeve Znj.Dibra dhe Z.Sokoli janë pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

**14.** Vijohet me pikën 14. të rendit të ditës: Pr/ Vendim “*Për një ndryshim në VKB nr.27, datë 1.6.2016 “Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor; shpërbimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër”*“

Përsëri fjala për Z.Dedaj, i cili përsëri relation për materialin e percatitur nga administrata duke sqaruar në mënyrë të detajuar rëndësinë e ndryshimit të kërkuar në pikën 1. të VKB-së nr.27 dt:1.06.2016.

Fjalën e merr Z.Galipi, i cili thekson dhe vlerëson ngritjen e një këshilli artistiko-kulturor për të vlerësuar dhe filtruar figura të njohura të artit në Shkodër por ai kërkon njëkohësisht që ky këshill të rrisë standartet dhe diapazonin e tij duke përfshirë edhe sportin.Gjithashtu ky pr/vendim sipas tij vjen i vonuar pas miratimit të buxhetit.

Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve, Znj.Dibra dhe Z.Sokoli shprehen pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 24 vota Pro, 1 Kundër, 1 Abstenim.

#### **Miratohet**

Znj.Kadija falenderon projektin e “Bashki të forta”, që në bashkëfinancim me ambasadën zvicerane kanë mundësuar logistikën e nevojshme për realizimin e transmetimit të drejtëpërdrejtë të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, duke rritur kështu transparencën e vendimmarjes në Këshill.

Kalohet në pikën e fundit të rendit të ditës: Diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr Z.Hasaj, i cili shprehet që është e disata herë që ngreh zërin për disa problematika në njësinë administrative Rrethina por asnjëra nuk ka marr zgjidhje. Në fshatin Golem në lidhje me ndricimin nuk është marr asnjë masë, po ashtu nuk është kryer edhe ndërryra në asfaltimin e rrugës tek varrezat dhe në rrugën “Hysaj”.Shqetësim tjetër mbetet edhe mirëmbajtja e rrugëve. Ai kërkon të dijë pse ndodh kjo zvarritje dhe neglizhencë e këtyre ndërryjeve.

Z.Dedaj përgjigjet duke thënë se shqetësimi i paraqitur nga Z.Hasaj nuk shqetëson vetëm atë, por edhe administratën e Bashkisë dhe thekson faktin që kjo nuk vjen si rrjedhojë e punës së munguar të administratës dhe përkushtimit të duhur por nga mungesa e fondeve për investime të tillë të domosdoshme.

Edhe Z.Halluni shprehet se shqetësimet e tij kanë rënë në vesh të shurdhët. Bashkia Shkodër ka nisur ndërtimin e një strehe për qentë e rrugës por a mund të dimë se në çfarë faze është sepse nuk shohim asnjë ndryshim të situatës. Dhe a është marr ndonjë masë për ndalimin e mjeteve që transportojnë qentë drejt Shkodrës.Po ashtu tjetër shqetësim janë pemët që po

kthehen në shqetësim të vazhdueshëm. Ai kërkon përsëri lirimin e hapësirave publike, sidomos të trotuareve.

Z.Dedaj shprehet se strehëza për qentë e rrugëve është planifikuar të kryhet në dy faza. Faza e parë ka përfunduar dhe shumë shpejt do të përfundojë edhe faza e dyte dhe do nisë puna në këtë strehë. Edhe në lidhje me transportin e qenve është diskutuar shumë edhe me Prefekturën. Në dijeninë e tij nuk është marrë ndonjë masë konkrete, prandaj vazhdon të mbetet problem. Edhe për pemët, ai personalisht ka kontaktuar firmën kontraktuese, por si duket në zonën që përmendet akoma nuk kanë mbërritur me grafikun e punës. Kurse përsa i përket hapësirave publike ai pranon që nuk është pika e tyre e fortë por po mendohet për një plan masash që shpresojmë të japë rezultatin e dëshiruar.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Znj.Kadija e deklaron mbledhjen të mbyllur.

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të dates 31.01.2023. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).*

*Procesverbali përmban 7 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:*

*Sekretar*

*Denis LESHA*



*KRYETARE*

*Brisa KADIJA*

